



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4468 Prot.

Tiranë, më 27.11.2019

Lënda: Kërkohej informacion shtesë mbi azhornimin e të dhënave për listat e kandidatëve të përcjella nga KLGJ shkresë nr.5693 prot, datë 15.11.2019 për hedhjen e shortit për zgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Drejtuar: Zonjës Naureda LLAGAMI
KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Për dijeni: Zonjës Erinda BALLANCA
AVOKATI I POPULLIT

TIRANË

E nderuar zonja Llagami,

Në vijim të shkresës sonë nr. 4329/1 Prot, datë 22.11.2019 dhe pas shqyrtimit të përgjigjes suaj nr. 5849/1 prot, datë 25.11.2019, ju bëjmë me dije se:

Në nenin 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, konkretisht përcaktohet se:

Neni 221

Kushtet dhe kriteret për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit dhe procedurat e përzgjedhjes

1. Mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm ata magistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) në kohën e hedhjes së shortit magistrati që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme ka ushtruar funksionin e magistratit për të paktën 10 vjet;***
- b) nuk ka një masë disiplinore në fuqi;***
- c) nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;***
- ç) shfuqizuar***

d) **shfuqizuar.**

dh) magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, **nëse janë të disponueshme;**

e) magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese **nuk është nën hetim** ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.

2. Kandidatët që nuk plotësojnë një nga këto kushte përjashtohen nga shorti.

3. Jo më vonë se data 15 nëntor e çdo viti kalendarik, Gjykata Kushtetuese, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë verifikojnë nëse kandidatët për anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, dhe i paraqesin Presidentit të Republikës dhe Kuvendit listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet.

4. Lista me kandidatët që i plotësojnë kushtet dhe lista me kandidatët që nuk plotësojnë kushtet bëhen publike në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

5. Kandidatët e përjashtuar njoftohen me shkrim, individualisht dhe në mënyrë të arsyetuar për shkaqet e përjashtimit. Ata mund të ankohen brenda 5 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

7. Presidenti i Republikës, në prani të Avokatit të Popullit, përzgjedh anëtarët e Këshillit me short midis datës 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik. Përveç anëtarëve të parashikuar në pikën 1, të nenit 220, të këtij ligji, Presidenti i Republikës zgjedh edhe një anëtar zëvendësues nga secili institucion në të njëjtin short.

8. Nëse Presidenti i Republikës nuk arrin të përzgjedhë anëtarët e Këshillit deri në datën 5 dhjetor, Kryetari i Kuvendit, në prani të Avokatit të Popullit, i përzgjedh ata brenda datës 10 dhjetor të atij viti kalendarik.

9. Presidenti i Republikës, miraton rregulla të mëtejshme për zhvillimin e procedurës së shortit, të cilat, në çdo rast, duhet t’u përmbahen parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit.

10. Rezultatet e shortit dhe përmbledhja e procesverbalit të procesit të shortit bëhen menjëherë publike në faqen zyrtare të internetit të Presidentit të Republikës.

11. Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit”.

Referuar dispozitave të pikës 1 dhe 2 të nenit 221 të sipërcituar rezulton se, mund të përfshihen në short vetëm ata kandidatë të cilët deri në **momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij neni.**

Në këtë mënyrë është e nevojshme shkëmbimi i informacionit midis institucioneve tona deri në momentin e hedhjes së shortit, të përcaktuar nga Presidenti i Republikës për tu zhvilluar në datë 5 dhjetor 2019.

Sjellim në vëmendjen tuaj se në listat e magistratëve të dërguar nga ana juaj me shkresë nr.5693 prot, datë 15.11.2019, gjendet dhe emri i gjyqtarit **Arben Vrionit**, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit

Durrës, i cili sipas informacionit të bërë publik në datë 22.11.2019 është shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Gjithashtu në listën e dërguar nga ana juaj është i përfshirë edhe emri i gjyqtarit **Arjan Balliu**, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, i cili sipas shënimit tuaj në listën e dërguar në datën 18.11.2019, ka patur seancën e shpalljes së vendimit pranë KPK-së. Sipas informacionit të bërë publik në media edhe gjyqtari Arjan Balliu është shkarkuar nga detyra në datë 18.11.2019 nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Pra nga informacioni i bërë publik rezulton se këta dy gjyqtar të cilët gjenden në listat e përcjella nga KLGJ, në zbatim të Nenit “E” dhe “F” të Kushtetutës dhe neneve 58, 61,62 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për shkak vendimmarrjes së KPK-së, këto gjyqtar konsiderohen të pezulluar nga detyra për shkak të ligjit. Lidhur me këtë informacion të bërë publik kërkojmë nga ana juaj të na konfirmoni plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për tu përfshirë ose jo në short të këtyre dy gjyqtarëve Arben Vrioni dhe Arian Balliu, apo të gjyqtarëve të tjerë të cilët mund të gjenden në të njëjtat kushte.

Ndërkohë referuar informacionit të përcjellë së fundmi me shkresën tuaj nr. 5849/1 prot, datë 25.11.2019, zoti Medi Bici, aktualisht anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor pasi është njohur me faktin që ndodhet në listën e kandidatëve të përjashtuar ka parashtruar ankim dhe çështja është në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërkohë që seanca e shqyrtimit ka qenë në datë 26.11.2019.

Në zbatim të parashikimeve të pikës 1 dhe 2 të nenit 221, të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar kërkojmë nga ana juaj verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve nga gjyqtarët e përfshirë në listën e dërguar nga ana juaj me shkresë nr. 5693 prot, datë 15.11.2019, deri në momentin e organizimit të shortit.

Duke qenë se plotësimi i kushteve dhe kriterëve të ligjit për kandidatët e përfshirë në listë për hedhjen e shortit për anëtarët e KED-së është një detyrim që duhet të përmbushet deri në momentin e organizimit të shortit (datë 5 dhjetor 2019), Presidenti i Republikës në mbështetje të nenit 92 germa h të Kushtetutës, kërkon nga Këshilli i Lartë Gjyqësor që të informohet në vijimësi me të gjithë informacionin e nevojshëm dhe të azhurnuar që ka të bëjë me listën e gjyqtarëve të dërguar nga institucioni juaj, me qëllim që në short të përfshihen ata kandidatë që plotësojnë kushtet ligjore.

Me qëllim përzgjedhjen e rregullt dhe sipas parashikimeve Kushtetuese dhe ligjore të përbërjes të Këshillit të Emërimeve në Drejtësisë, informacioni për çdo të dhënë shtesë që shërben për azhurnimin e përbërjes së listës dhe kandidatëve që kualifikohen, të dërgohet në çdo kohë përpara momentit të hedhjes së shortit, datë 5 dhjetor 2019.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ORNELA ZONJA

